

## **STATUTI DHE AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE TREGETARE “BRAYAL-CONSTRUCTION” shpk**

#### **KREU I**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

##### **NENI 1**

Sot me date 03.07.2023 sipas kerkesave te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite trgetare” dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit,i perditesuar krijohet shoqeria tregtare **“BRAYAL-CONSTRUCTION” Shpk**, e cila do te veproje ne perputhje me legjisacionin shqiptar ne fuqi, nenet e ketij statuti si dhe aktit bashkengjitur tij.

#### **KREU II**

#### **EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

##### **NENI 2**

Formohet shoqeria tregetare e emertuar **“ BRAYAL-CONSTRUCTION ” sh.p.k.** me themelues;

- **Z. Ismet Leka i datelindjes 20.05.1980, lindur ne Diber, dhe banus ne Tirane.**

##### **- NENI 3**


Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me perqejjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

##### **NENI 4**

- **Selia e shoqerise tregetare private “BRAYAL-CONSTRUCTION ” shpk, do te jetë ne adresen:**
- **Ruga Co-Plan, Bathore 1, ndertesa nr 25, Kati I, Kamez, Tirane.**
- Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative ne gjithe territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashtë vendit.

##### **NENI 5**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Z. Ismet Leka". Below the signature, the number "523" is written vertically.

## NENI 6

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje “ **BRAYAL-CONSTRUCTION** ” sh.p.k.

## KREU III

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

## NENI 7

### **Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:**

- Sherbime ndertimi, rikonstruksion objektesh te ndryshme, punime murature, suvatime, Import-Eksport dhe shitje mallrash te ndryshme, lende te para, industriale, makineri pajisje, etj.

## **KAPITALI**

## NENI 8

### **Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke,dhe zoterohet si me poshte:**

- Z. Ismet LEKA zoteron 100% te kuotave me vlore nominale 100,000 leke kouta.

**Kapitali eshte ne vlore 100,000 leke e ndare ne 1 kuote, vlera e te cilit eshte 100,000 leke.**

Kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

## NENI 9


Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakut te vetem, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

## NENI 10

Ortaket mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi tua kene ofruar per blerje ortakut brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta i komunikohet me shkrim ortakut te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

## NENI 11

Kapitali shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme e te paluejteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.



## **NENI 12**

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

## **KREU IV**

### **ORGANET DREJTUESE**

## **NENI 13**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- **Ortaket:**

### **1- Ismet LEKA me nr ID I00520109R**

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte:

## **ASAMBLEJA**

### **NENI 14**

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Ajo mblidhet sa here e shohin te arsyeshme ortaket, por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise. Asambleja i merr vendimet e ortakeve , pavec rasteve te parashikuara ne statut.

## **NENI 15**

Asambleja vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, shtimin ose pakesimin e kapitalit, per emerimin e organit administrativ, per drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise.

## **ORGANI ADMINISTRATIV**


## **NENI 16**

**Administrator i shoqerise “BRAYAL-CONSTRUCTION” shpk do te jetë :**

- **Z. Ismet Leka, me Nr ID I00520109R me afat 5 vjeçar.**

## **NENI 17**

Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet per perm bushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.



Organi Administrativ eshte kompetent per :

- te miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturen e aparatit te shoqerise;
- marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta;
- propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta ), ndarjen e fitimit, etj. ;
- perfaquesuar apo emeruar perfaquesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria;
- perfaquesuar shoquerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.

## KREU V

### KUSHTET EKONOMIKE

#### NENI 18

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdomim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

#### NENI 19

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

#### NENI 20

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne organet tatimore, ndersa vitete tjera ne Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo vit Ne cdo fund periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes nxirret bilanci. Bilancet periodike ( mujore, tremujore e gjashtemujore) miratohen e nenshkuhen nga Administratori e me pas ratifikohen ne asamblene e radhes. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nenshkuhen nga administratoret.

#### NENI 21

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdomim ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise,mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi i rezerves ligjore, sipas vendimeve te asamblese.

**KREU VI**  
**MAREDHENIET E PUNES**  
**NENI 22**

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne to zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R.Sh. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

**KREU VII**  
**NENI 23**

Veprimitaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese per shkaqet:

- veprimitaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut te vetem
- riorganizohet ne nje forme tjeter

**NENI 24**

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti asambleja cakton nje ose me shume likujdatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer gjithe veprimet e likujdimit te saj, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakut, ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit ortaku eshte i detyruar te derdhi kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 25**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

**NENI 26**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje asambleja si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete statuti.


**NENI 27**

Ky statut u perpilua ne prani te ortakut duke shprehur vullnetin e tij te lire. Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane, ne zyren e Tatim -Taksave dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**O R T A K E T**

E  
**THEMELIMIT TE SHOQERISE "BRAYAL-CONSTRUCTION" shpk**

Ismet LEKA



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Ismet LEKA". Below the main name, there is a smaller, stylized signature or date that appears to read "08.03".